



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 11 prot

Tepelenë, më 31.10.2025

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 31.10.2025, ora 10:00 në Pallatin e Kultures (kati II dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

- Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
- Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 30.09.2025.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shtator 2025”.
- **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Shtator 2025”.
- **Projektvendim:** “Për dhënie titull nderi.”
- **Projektvendim:** “Për miratim dhënie ndihme financiare për dëmin e shkaktuar nga zjarri në ullishte e pemtari.”
- **Projektvendim:** “Për përdorimin e fondit për individë për ndihme të menjëhershme.”
- **Projektvendim:** “Për parandalimin dhe adresimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës.”
- Raportim për problematikat dhe veprimtarinë në Njësitë Administrative (Qëndër, Lopës, Kurvelesh) të Bashkisë Tepelenë.
- Çështje të tjera “Për një shtesë në buxhetin e miratuar të vitin 2025, në programin buxhetor mbrojtja nga zjarri.”
- Kërkesa ankesa të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, Z. Arben Gumeni:

Përshëndetje të gjithëve. Fillojmë me mbledhjen e datës 31.10.2025. Do të nisim me rendin e ditës. Pika e parë është miratimi i rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? Ta hedhim në votim.”

Pro: 13 vota Arben Gumeni, Mjaftoni Zeraj, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Matilda Çela, Marios Jorgo, Besnik Maca, **Kundër:** Asnjë, **Abstenim:** Asnjë

Pika e dytë e rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 30.09.2025.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, Z. Arben Gumeni, u drejtohet këshilltarëve me pyetje në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, duke kërkuar nëse kanë vërejtje apo sugjerime. Kryetari deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit.

Pro: 13 vota Arben Gumeni, Mjaftoni Zeraj, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Marios Jorgo, Besnik Maca, **Kundër:** Asnjë, **Abstenim:** Asnjë

Pika e tretë e rendit të ditës

“Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin shtator 2025.”

Fjalën e mori **Znj. Matilda Çela**, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë: Komisioni i Ekonomisë, i mbledhur ditën e djeshme, është njohur me materialin për ndihmën ekonomike për muajin shtator. Janë 10 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6%, një familje është hequr nga skema për shkak të një gabimi në sistem dhe është përfshirë në fondin e Bashkisë, në njësinë administrative Kurvelesh.

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni: Ka pyetje për këtë projektvendim? Nëse jo, ta hedhim në votim.”

Pro: 13 Arben Gumeni, Mjaftoni Zeraj, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Matilda Çela, Marios Jorgo, Besnik Maca, **Kundër:** S’ka, **Abstenim:** S’ka

Pika e katërt e rendit të ditës

“Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin shtator 2025.”

Fjalën e mori përsëri **Znj. Matilda Çela**, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë: Për muajin shtator trajtohen nga fondi i Bashkisë gjithsej 91 familje, me një fond prej 231.178 lekësh. Janë

shtuar 3 familje të reja: 1 në njësinë Qytet dhe 2 në njësinë administrative Kurvelesh, sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni: Ka pyetje? Nëse jo, ta hedhim në votim.

Pro: 13 vota Arben Gumeni, Mjaftoni Zeraç, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Matilda Çela, Marios Jorgo, Besnik Maca, **Kundër:** S'ka, **Abstenim:** S'ka

Pika e pestë e rendit të ditë ; “Për dhënie titulli nderi.”

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni; Ne kemi thënë që tituj nderi do jepen çdo 6 muaj, titujt e nderit duhet t'u jepen personave që të kenë kontribuar për bashkinë, ndërsa për vendosje busti të bëhen me kriter të jenë figura që përfaqësojnë vlera kombëtare, p.sh. hero i popullit, nderi i kombit, dhe propozimet të kalojnë më parë në Komisionin e Bashkisë dhe në Komisionin e Këshillit për verifikim.

Vladimir Bakiaj: Administrata e bashkisë të sigurojë dokumentacionin e plotë nga shoqatat komisioni të kontrollojë se çfarë shkruhet në dokumente.

Ditar Hodaj: Po abuzohet me titujt nderi më shumë seriozitet nuk paragjykoj.

Latif Kacaj: Kërkesa për vendosje busti nga shoqata që nuk plotësojnë kriteret mos të vijnë në këshill.

Mirela Varfi: Komisioni u mbledh dje, diskutoi materialin dhe vendosi ta kalojë në Këshill tre propozimet për tituj nderi (sipas relacionit bashkëlidhur).

Ditar Hodaj: çfarë kritere të veçanta plotësojnë individët e propozuar.

Mirela Varfi; Dokumentacioni është kaluar në komision dhe vendimi merret me votim të Këshillit.

Arben; Ka pyetje, ta hedhim në votim.

Pro: 11 Arben Gumeni, Mjaftoni Zeraç, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Matilda Çela, Besnik Maca, **Kundër:** 2 vota, **Abstenim:** Asnjë.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

Pika 6 u hoq nga rendi i ditës pasi Zyra e Emergjencës Civile nuk kishte sjellë materialin e nevojshëm për shqyrtim, kjo pikë do të kalojë në mbledhjen e radhës.

Spiro Kora: Vlera e propozuar nuk përputhej me vlerën reale, për këtë arsye materiali kërkon verifikim para paraqitjes përsëri.

Pika e shtatë e rendit të ditës:Projektvendim: Për përdorimin e fondit për individë për ndihmë të menjëhershme.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë:Në Bashkinë Tepelenë kanë ardhur tre kërkesa për ndihmë financiare.

Kërkesa e parë është nga qytetari **Agron Rama**, për përballimin e situates së vështire ekonomike

Kërkesa e dytë nga qytetarja **Sose Murata**, për përballimin e situatës së vështirë ekonomike;

Kërkesa e tretë, ardhur dje nga Bashkia, është për dhënie ndihme financiare për shpenzimet e varrimit të djalit të qytetarit **Mustafa Qenani**.
Materialet përkatëse i keni përpara.

Ditar Hodaj: E para dokumentacioni është diskutuar me një mjek specialist, dhe e dyta shërbimet mjekësore do e marrin nga shteti apo privat?

Arta Shaha: Të dyja kërkesat janë të mbështetura mbi diagnozat e përcaktuara në dokumentacion nga mjeku,

Ditar Hodaj: Cfarë diagnoze kanë?

Arta Shaha: Diagnozat përcaktohen nga mjekët në dokumentet përkatëse, ndërsa bashkia bën vlerësimin social-ekonomik.

Ditar Hodaj:Nuk keni bere konsulenc mjekesore dokumentacioni është i cunguar nga ana mjekësore dhe kërkoi që Bashkia të ketë staf mjekësor të dedikuar për këto raste, kërkesa janë pa datë.

Arta Shaha: Kërkesat janë dërguar përmes emailit zyrtar.

Mjaftoni Zera: Duke u bazuar në materialin e paraqitur dhe gjendjen social-ekonomike të përfituesve, si dhe në epikrizat përkatëse, jam pro dhënies së ndihmës financiare.

Ditar Hodaj: Duhet të ketë vlerësim nga personel mjekësor material.

Spiro Kora: Në Bashki vijnë shumë kërkesa për ndihmë ekonomike. Aktualisht Drejtoria e Financës është në fazën e hartimit të Projektbuxhetit 2026 dhe do të shqyrtojë propozimin për shtesë në personelin mjekësor. Do të përgatitet një dokument i strukturuar për mënyrën e trajtimit të ndihmave ekonomike, në mënyrë që Këshilli të mos shqyrtojë çdo muaj raste individuale, por të përcaktojë më qartë në buxhet.

Kryetari, Z. Arben Gumeni: Ndihmat e menjëhershme financiare duhet të bazohen në verifikimin e gjendjes social-ekonomike, si nga Bashkia ashtu edhe nga vetë Këshilli.

Kryetari: Ka pyetje, ta hedhim në votim projektvendimin.

Pro: 13vota Arben Gumeni, Mjaftoni Zeraç, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Matilda Çela, Marios Jorgo, Besnik Maca, **Kundër:** Asnjë, **Abstenim:** Asnjë

Pika e tetë e rendit të ditës; Projektvendim: “Për parandalimin dhe adresimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës.”

Ditar Hodaj: Kam lexuar materialin e konsideroj shkelje të të drejtave të njeriut dhe nuk shoh arsye që të vijë për miratim në Këshill. Pse duhet ta kalojmë këtë në Këshill, kur ka kod i etikës

Arta Shaha: Ky dokument ka për qëllim mbrojtjen e punonjësve të Bashkisë nga çdo formë dhune apo ngacmimi në vendin e punës.

Ditar Hodaj: Sërish mendoj se është e panevojshme, pasi ka kod etike

Mirela Varfi: Kjo është një rregullore e sjellë nga Bashkia, në zbatim të udhëzuesve ligjorë për parandalimin e dhunës në vendin e punës.

Arta Shaha: Bëhet fjalë për miratimin e udhëzuesit përkatës.

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni: Në parim jemi dakord. Materiali ka ardhur nga Bashkia, ndaj ta kalojmë në votim.

Pro: 9 vota Arben Gumeni, Mjaftoni Zeraç, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, **Kundër:** 2, **Abstenim:** 2

Pika e nëntë e rendit të ditës; Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e miratuar të vitit 2025, në programin buxhetor ‘Mbrojtja nga zjarri’.”

Z. Spiro Kora Drejtori I zhvillimit ekonomik dhe menazhimit financiar; Projektvendimi mbështetet në:

Ligjin nr. **139/2015**, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’”, neni 44;

Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46;

Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 27.11.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”;

Shkresën nr. 14505/11, datë 24.10.2025, “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025.”

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, është përcaktuar shtesa e fondeve në transferte të pakushtëzuar sektoriale për funksionin “Mbrotja nga zjarri dhe shpëtimi”. Ky fond është akorduar për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve, në masën deri në një pagë mujore për secilin punonjës.

Shtesa në buxhetin e miratuar për vitin 2025 është në shumën 1,302,000 (një milion e treqind e dy mijë) lekë, e transferuar nga buxheti i shtetit si transferte e pakushtëzuar sektoriale.

Ditar Hodaj: Kjo transfertë është për shpërblim?

Spiro: Po, është për shpërblim. Është një veprim i kushtëzuar me akt normativ.

Esmeralda Bishani: Kur do të realizohen shpërblimet?

Spiro: Shpërblimi do të kryhet bashkë me pagesën mujore.

Kryetari: Ka pyetje, ta hedhim në votim projektvendimin

Pro: 13 vota Arben Gumeni, Mjaftoni Zera, Latif Kacaj, Marsela Balili, Ilir Haska, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Matilda Çela, Marios Jorgo, Besnik Maca, **Kundër:** S’ka, **Abstenim:** S’ka

Spiro: Kam një informacion të shkurtër mbi situatën e detyrimeve ndaj **FSHU** dhe kërkesën për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.

Ky raport paraqitet për informimin e Këshillit Bashkiak lidhur me situatën aktuale të marrëdhënieve financiare ndërmjet Bashkisë Tepelenë dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal të Energjisë Elektrike (FSHU), si dhe kërkesën e këtij subjekti për likuidimin e detyrimeve të prapambetura deri më 31 tetor 2025, në të kundërt të cilës FSHU ka paralajmëruar ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për disa objekte në administrim të bashkisë.

Gjendja aktuale

Sipas njoftimit zyrtar të marrë nga FSHU, Bashkia Tepelenë rezulton me detyrime të papaguara që datojnë që nga viti 2007 e në vijim. Shuma totale e pretenduar nga FSHU është 122,000,000 lekë, e cila përfshin:

- Faturime mujore për periudha të mëparshme;
- Kamata vonesa të akumuluar ndërmjet vite;
- Penalitete për vonesa në pagesa.

Në rast moslikuidimi brenda afatit të përcaktuar, FSHU ka paralajmëruar ndërprerjen e energjisë elektrike për disa njësi dhe institucione nën administrimin e Bashkisë, përfshirë ndriçimin publik, godinat administrative dhe disa institucione arsimore.

Qëndrimi i Bashkisë

Bashkia Tepelenë, përmes strukturave të saj financiare dhe juridike, ka kundërshtuar vlerën e pretenduar nga FSHU, duke argumentuar se:

- Ekziston mbifaturim i përsëritur në disa kontrata të lidhura gjatë periudhës 2007–2014;
- Në disa raste faturimet nuk janë bazuar në matje reale të konsumit, por në vlera të përafërta ose të përlogaritura;
- Ka pasur ndryshime të ndjeshme në kushtet kontraktuale dhe tarifat e aplikueshme ndër vite, të cilat kanë ndikuar në rritjen artificiale të detyrimeve;
- Një pjesë e detyrimeve është objekt i procesit gjyqësor në zhvillim me FSHU, që synon përcaktimin e detyrimit real financiar të bashkisë.

Veprimet e ndërmarra

- Është kërkuar nga Bashkia rakordim i detajuar i detyrimeve ndër vite me FSHU, mbi bazën e kontratave përkatëse dhe të dhënave të matësve realë.
- Është depozituar kërkesë për ekspertizë financiare në procesin gjyqësor për të përcaktuar saktësisht vlerën e detyrimit.
- Është kërkuar pezullimi i çdo mase ndërprerjeje të energjisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor, për të mos cënuar funksionimin normal të institucioneve publike.

. Rreziku dhe ndikimi i mundshëm

Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike do të sillte pasoja të drejtpërdrejta në:

- Ndriçimin publik të qytetit dhe njësive administrative;
- Funksionimin e godinave të administratës së bashkisë;
- Institucionet arsimore, kulturore dhe sociale;
- Shërbimet bazë për qytetarët.

Një masë e tillë do të pengonte ushtrimin e funksioneve publike dhe do të krijonte ndikim negativ në mbarëvajtjen e jetës komunitare dhe të punës së institucioneve.

Rekomandime për Këshillin Bashkiak

1. Të njoftohet zyrtarisht FSHU për procesin gjyqësor në vijim dhe për qëndrimin e Bashkisë Tepelenë mbi mbifaturimet e konstatuara.
2. Të kërkohet nga FSHU pezullimi i çdo mase ndërprerjeje deri në verifikimin përfundimtar të detyrimeve nga ekspertiza financiare.
3. Të autorizohet Drejtoria e Financës për të vijuar me rakordimin e detyrimeve të pranuar si reale dhe të kërkojë korrektim të faturave të kontestuar.
4. Të shqyrtohet mundësia për likuidimin e detyrimeve të verifikuara si të sakta, ndërkohë që pjesa e mbetur të mbetet pezull deri në përfundimin e procesit gjyqësor.
5. Të kërkohet ndërhyrja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë / ERE për ndërmjetësim institucional dhe garantimin e vazhdimësisë së furnizimit për objektet publike.

Bashkia Tepelenë mbetet e angazhuar për zgjidhjen ligjore dhe financiare të çështjes me FSHU, duke kërkuar transparencë në faturime dhe respektim të kushteve kontraktuale. Deri në

përfundimin e verifikimit dhe procesit gjyqësor, Bashkia vlerëson se nuk mund të pranojë si detyrim të saktë shumën e pretenduar, për shkak të mospërputhjeve të konstatuara ndër vite.

Kërkohet mbështetja e Këshillit Bashkiak për ndjekjen institucionale të çështjes dhe për garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike për shërbimet publike të qytetarëve.

Ditar Hodaj: Kjo pikë do të kalojë për miratim apo është vetëm për informim?

Spiro: Është për informim. Kemi njoftuar me shkresë bashkëpunimi institucionet përkatëse, për të gjetur dakordësi deri në detyrimin përfundimtar. sipas vendimit gjyqësor. Ne kemi marrë përsipër likuidimin e faturave elektrike dhe një pjese të detyrimeve të prapambetura, deri në momentin e arritjes së marreveshjes për detyrimin final, ata do të kenë akses në arkrtimin e detyrimeve koherente dhe një ose dy fatura te detyrimeve të prapambetura.

Arben Gumeni: Këto detyrime të FSHU janë për mbifaturime? Ju si bashki, pse nuk rakordoni me OSHEE, që në momentin e leximit të matësit të jetë prezent një punonjës i bashkisë, në mënyrë që të mos ketë mbifaturime.

Spiro: Kjo çështje deri në vitin 2022. Nga viti 2022 kemi rënë dakord me OSHEE dhe pagesat janë në vazhdim; aktualisht situata është në rregull. Në gjykatë kemi paraqitur leximet e matësive në një datë të përbashkët, të kryer nga një komision i ngritur nga bashkia në bashkëpunim me teknikë të fushës përkatëse, dhe faturat janë përcaktuar mbi bazën e atyre leximeve.

Vladimir Bakiaj: A ka bashkia detyrime të tjera ndaj institucioneve, për shembull ndaj ujësjellësit?

Spiro: Me ujësjellësin çështja është zgjidhur me marrëveshje.

Arben Gumeni: Bashkia të vazhdojë me marrëveshje.

Ditar Hodaj: Shuma është në lekë të reja apo të vjetra?

Spiro: Në lekë të reja.

Arben Gumeni: Kalojmë tek pika 9 e rendit të ditës.

Pika 9 e rendit të ditës: Raportim për problematikat dhe veprimtarinë në Njësitë Administrative (Qendër, Lopës, Kurvelesh) të Bashkisë Tepelenë.

Arben Gumeni: Fillojmë me raportimin e Njesisë Administrative Kurvelesh.

Shaban Loçi, Administrator i Njesisë Kurvelesh, relatton materialin bashkëlidhur.

Arben Gumeni: Ka pyetje?

Ditar Hodaj: Të falënderoj për materialin që ke paraqitur. Për vendosjen e ndriçuesve diellorë, a janë përfshirë në projekt për Lekdush, Progonat dhe Gusmar?

Shaban Loçi: Po, janë në projekt.

Ditar Hodaj: Shkolla në Nivicë e kam përmendur edhe më parë —një klasë ka nevojë për ndërhyrje. Po ashtu, varrezat e Kurveleshit, objekti është në gjendje të dëshiruar; duhet ose të priset, ose të ndërhyhet. Të falënderoj për punën e bërë.

Matilda: Shkolla në Nivicë, kur do të ndërhyhet? Nxënësit kanë filluar mësimin.

Shaban Loçi: Klasa në Nivicë nuk është ambient i përshtatshëm për mësim.

Arben Gumeni: Të ndërhyhet në atë objekt, edhe pse nuk është objekt shkollor.

Arben Gumeni: Tani fillojmë me raportimin e Administratorit të Njesisë Administrative Qendër.

Leonidha Shumeli, Administrator i Njesisë Qendër, relaton materialin bashkëlidhur.

Latif Kaçaj: Rruga **Dukaj–Sinanaj**, kush e ka në patronazh për pastrim?

Vladimir Bakiaj: Jam dakord me punët e kryera. Në lidhje me vëzhguesit, a marrin ata pagesën?

Mjaftoni Zeraaj: Në Njësinë Administrative Qendër, a janë zgjidhur konfliktet në fshatin Salari për rrugën midis dy banorëve të fshatit? E pyes, pasi unë kam drejtuar atë mbledhje dhe më kërkojnë informacion.

Mirela Varfi: Të falënderoj për materialin, por ka ende punë për t'u bërë. Duhet të vendosen **konteinerët e mbeturinave** në lagjen kordhaj të ndërhyhet për **rrugën e lagjes Kordhaj**, dhe në **lagjen e Fushës** të vendoset ndriçim publik.

Arben Gumeni: Si funksionon ndriçimi me panele diellore?Kur do të vendosen në të gjitha fshatrat, duhet të investohet më shumë në këtë drejtim.

Leonidha Shumeli: Në lidhje me rrugën Dukaj–Lopës, kufijtë janë deri tek përroi i Salarisë.

Personat vëzhgues nuk kanë qenë produktivë; ata janë me kontratë dy mujore dhe paguhen vetëm për këtë periudhë.

Për problemin e rrugës në fshatin Salari, çështja ka dy vjet që ka kaluar në Këshillin Bashkiak. Ne e kemi hapur rrugën, por pas disa kohësh ajo është bllokuar nga banorët. Çështja është dërguar në Prokurori dhe pritet vendim gjyqësor. Nga ana e bashkisë po shihet mundësia që kjo rrugë të shtrohet me beton, për ta bërë të kalueshme. Për këtë është i nevojshëm një projekt, pasi rruga është pjesë e hartës zyrtare.

Rruga për në lagjen Kordhaj është përfshirë në objektivat e bashkisë për mirëmbajtje.

Për ndriçuesit në lagjen tuaj do të ndërhyhet gjatë ditëve në vijim.

Kazanët e plehrave janë dërguar në Kordhaj.

Ndriçimi diellor po zbatohet nga Fondi i Zhvillimit, jo drejtpërdrejt nga bashkia, për shkak të kostos së lartë. Megjithatë, panelet diellore kanë rezultuar efektive.

Ditar Hodaj: A janë parashikuar në shpërblimin që miratuar më parë edhe ata persona (vëzhguesit)?

Leonidha Shumeli: Jo, nuk janë përfshirë.

Arben Gumeni: Ju falënderoj për materialin e paraqitur.
Tani kalojmë tek informacioni i Njesisë Administrative Lopës.

Latif Kaçaj: Kush do ta lexojë informacionin?

Vladimir Bakiaj: Të vijë në mbledhje administratori për të dhënë informacion.

Arben Gumeni: Ju vendosni se si do vendoset, por administratori të vijë për të paraqitur materialin. Të njoftohet administratori dhe kryetari i bashkisë

Kërkesa/ankesa nga qytetarët

Z. Neim Zhupa – kërkesë për vendosje pllake përkujtimore

Kjo kërkesë t'i kalojë zyrës përkatëse të bashkisë për shqyrtim.

Znj. Elmazije Mihaj, banore e qytetit Tepelenë, kërkon vend strehimi pasi nuk ka banesë dhe ndodhet në kushte të vështira financiare.

Kërkesa për tu vlerësuar dhe ndihmuar pasi zonja është **pensioniste**.

Z. Jaho Shehu, banor i fshatit Veliqot, Njësia Administrative Qendër, kërkon shpërblim për dëmin e shkaktuar nga zjarri.

Kërkesa t'i kalojë zyrës përkatëse të bashkisë për verifikim.

Z. Ferdinand Varfa, banor i fshatit Dukaj, Njësia Administrative Qendër, kërkon ndihmë për rikonstruksion banese.

Kërkesa t'i kalojë zyrës përkatëse të bashkisë për verifikim.

Znj. Xheko Dervishi, banore e Bashkisë Tepelenë, kërkon rikonstrukcion të banesës nga bashkia, pasi ndodhet në kushte të vështira ekonomike.

Kërkesa t'i kalojë zyrës përkatëse të bashkisë për verifikim.

Marios Jorgo: Shkolla Avni Rustemi ka problem me dritaret që janë dëmtuar nga era, inaugurimi nuk është bërë akoma dhe mësimi ka filluar. Kondicionerët gjithashtu kanë probleme.

Matilda: Administratori i qytetit të vijë në mbledhjen e radhës për të dhënë informacion edhe për shkollën.

Ditar Hodaj: Shkolla ka mbaruar apo jo? Është marrë në dorëzim apo jo?

Arben Gumeni: Në mbledhjen e radhës do të merret informacion nga administrata për shkollën Avni Rustemi.

Mbyllja e mbledhjes: Ora 11:42

Ju falemindetit

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI

